

MANUALI I GJYQTARIT PËR LËSHIMIN E URDHRAVE TË MBROJTJES



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



MANUALI I GJYQTARIT PËR LËSHIMIN E URDHRAVE TË MBROJTJES

© USAID dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2008.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ISBN: 978-92-9235-201-1

Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara apo të Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë.

FALENDERIME

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe USAID falenderojnë ata të cilët dhanë kontributin e tyre për përgatitjen e “Manualit të gjyqtarit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes”. Dianne Post e hartoi manualin për Nismën për të Drejtat e Grave, USAID në vitin 2006. Ajo u mbështet në përvojën e saj të bashkëpunimit me profesionistë shqiptarë në kuadrin e ngritjes së një grupi të reagimit të koordinuar të komunitetit (GRKK) për zbatimin e ligjit të ri të dhunës në familje. Manuali u botua për herë të parë nga USAID në muajin nëntor të vitit 2006. Autorja dhe Maya Goldstein, nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e përditësuan manualin në muajin maj të vitit 2008, pas hyrjes në fuqi të ligjit të dhunës në familje në qershor të vitit 2007. Arta Mandro, nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe stafi i projektit “Nisma për të Drejtat e Grave” të Chemonics International kanë bërë komente me vlerë. Frank Dalton, nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, redaktoi tekstin e variantit anglisht dhe shqip të manualit, me ndihmën e Ama Krajës. Botimi i variantit të përditësuar të këtij manuali u financua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Tabela e lëndës

| | |
|---|----|
| Hyrje | 6 |
| Çfarë është dhuna në familje?..... | 8 |
| Cilat marrëdhënie familjare përfshihen në ligj?..... | 10 |
| A ka më shumë se një lloj urdhër mbrojtjeje? | 10 |
| Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje? | 11 |
| Kush mund t'i lëshojë urdhrat e mbrojtjes? | 13 |
| Cilat janë afatet kohore për të lëshuar një urdhër mbrojtjeje? | 14 |
| Çfarë lloje urdhrash mund të lëshohen? | 14 |
| Çfarë duhet të përmbajë kërkesë-padia? | 19 |
| Ku paraqitet kërkesë-padia? | 19 |
| Kur do të zhvillohet seanca? | 20 |
| Cilat prova mund të pranohen në gjykatë? | 20 |
| Kush mund të dëshmojë në seancë? | 21 |
| Po nëse seanca është për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes? | 22 |
| Kur duhet ta lëshojë gjykata urdhrin e mbrojtjes? | 22 |
| Çfarë përmban vendimi? | 23 |
| A ka procedurë për ankimim, ndryshim apo ndërprerje? | 24 |
| Kush njoftohet pasi lëshohet urdhri? | 25 |
| Kur hyn në fuqi urdhri? | 25 |
| Kush ka detyrimin për ta ekzekutuar urdhrin? | 26 |
| Çfarë ndodh nëse shkelet një urdhër mbrojtjeje? | 26 |
| Roli i veçantë i gjykatave për t'i dhënë fund dhunës në familje | 28 |
| Dhënia e drejtimit | 28 |
| Spektatorët dhe dëshmitarët | 29 |
| Viktimat | 29 |

| | |
|--|-----|
| Çështjet etike | 31 |
| Siguria në gjykatë | 31 |
| Si mund të ndihmojnë gjyqtarët | 32 |
| Ruajtja e sekretit | 33 |
| Praktikat më të mira për të ndaluar dhunën në familje | 34 |
| Përgjegjësia e të paditurit | 35 |
| Programet e rehabilitimit të dhunuesit | 37 |
| | |
| SHTOJCAT | 43 |
| Shtojca A. Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar | 44 |
| Shtojca B. Ligji nr. 9749, datë 4 qershor 2007, “Për policinë e shtetit” - pjesë | 68 |
| Shtojca C. Seanca e urdhrit të mbrojtjes | 70 |
| Shtojca Ç. Kërkesë-padia për urdhrin e mbrojtjes | 80 |
| Shtojca D. Kërkesë-padia për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes | 86 |
| Shtojca DH. Kërkesë për modifikimin e urdhrit të mbrojtjes | 91 |
| Shtojca E. Urdhri i mbrojtjes | 94 |
| Shtojca Ë. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes | 100 |
| Shtojca F. Pyetje themelore | 105 |

HYRJE

Në janar 2006, 20.000 shqiptarë shprehën qartë mendimin e tyre se dhuna në familje është një problem serioz. Për herë të parë, në Kuvend u paraqit një kërkesë e qytetarëve për të miratuar një ligj - ligj që do të ndihmojë viktimat e dhunës në familje. Ligje të tilla janë të zakonshme në botë dhe Evropë dhe të detyrueshme nëse Shqipëria dëshiron të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian. Në dhjetor 2006, Kuvendi miratoi ligjin nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”¹ (ligji për dhunën në familje).

Qëllimi i ligjit është të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të garantojë mbrojtje ligjore për anëtarët e familjes, të cilët i nënshtrohen dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar (neni 1). Sipas ligjit të ri, çdo pjesë e shoqërisë luan rol në parandalimin e dhunës. Ligji parashikon rolet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe strukturave zbatuese si p.sh., drejtorive të policisë, zyrave të urgjencës dhe organeve të qeverisë vendore për të parandaluar dhunën në familje dhe për të mbrojtur ata të cilët viktimizohen prej saj.

Gjykatat luajnë një rol të rëndësishëm në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes të cilat janë masa civile. Ligji shprehimisht parashikon

¹ Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12 maj 2008, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”.

fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes për viktimat dhe sigurimin e shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë për to (neni 2). Prokurorët kanë rolin e tyre duke ndërhyrë në veprimet penale. Shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore dhe OJF-të marrin pjesë në një përgjigje të koordinuar të komunitetit për të mbështetur, mbrojtur dhe rehabilituar viktimat e abuzimit.

Manuali i gjyqtarit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes ka për qëllim t'i pajisë gjyqtarët me një mjet të dobishëm për të interpretuar dhe zbatuar ligjin e ri të dhunës në familje. Ai fillimisht përshkruan veçoritë e ligjit dhe bashkëveprimin e tij me legjislacionin ekzistues. Më pas, manuali i udhëzon gjykatat për të zbatuar në mënyrë sa më të efektshme ligjin. Shtojcat përfshijnë formularë për kërkesë-padi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, formularë model që shërbejnë si vendim gjykate për urdhër mbrojtjeje dhe procedura të detajuara për zhvillimin e një seance gjyqësore.

Ky manual shpreson t'u ofrojë gjyqtarëve shqiptarë, si dhe individëve e organizatave ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë, një udhëheqje praktike në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të mbrojtur në mënyrë të efektshme viktimat e dhunës në familje.

Çfarë është dhuna në familje?

Neni 3 specifikon se dhunë në familje quhet çdo veprim i një personi ndaj një personi tjetër, kur ata janë në një marrëdhënie të caktuar, i cili sjell si pasojë dëmtim. E njëjta dispozitë përcakton gjithashtu se dhunë në familje quhet çdo mosveprim (d.m.th neglizhencë) kur ka ekzistuar detyrimi ligjor për të vepruar.

Secila prej veprave penale të mëposhtme të Kodit Penal (KP) mund të quhet dhunë në familje kur kryhet midis pjesëtarëve të familjes.

- Vrasja (nenet 76 - 83, 85 të KP-së)
- Kanosja (neni 84)
- Plagosja (neni 88/b)
- Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas (neni 93)
- Mosdhënia ndihmë (neni 97)
- Shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99)
- Rrëmbimi (neni 109, 109/a)
- Trafikimi (neni 110/1 dhe neni 114/b, për të miturit neni 128/b)
- Dhunimi i banesës (neni 112)
- Shfrytëzimi i prostitucionit (neni 114)
- Fyerja (neni 119)
- Shpifja (neni 120)
- Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar (neni 261)
- Ndërrhyrje të padrejta në jetën private (neni 121)
- Marrëdhënie seksuale (nenet 100-107)
- Vepra të turpshme (neni 108)
- Braktisja (neni 124)
- Mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125)

- Marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127)
- Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130)
- Shkatërrimi i pronës ose mirëqenies ekonomike (nenet 150-154)
- Kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (vjedhja me dhunë/vjedhja nenet 139 dhe 134)
- Plagosja e rëndë me dashje (neni 88, 88/a)
- Plagosja e lehtë me dashje (neni 89)
- Dëmtime të tjera me dashje (neni 90)
- Plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91)
- Plagosja e lehtë nga pakujdesia (neni 92)
- Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275)

Gjithashtu, edhe veprimet e mëposhtme mund të përbëjnë dhunë në familje sepse ato shkaktojnë dëmtime:

- pengimi në mbajtjen e mjeteve monetare,
- përçmimi,
- abuzimi i drejtpërdrejtë fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik i fëmijëve,
- vendosja e këtyre të fundit në situata të rrezikshme ku ata bëhen dëshmitarë të dhunës.

Kjo e fundit i referohet dhunuesit dhe jo viktimës.

Cilat marrëdhënie familjare përfshihen në ligj?

Sipas ligjit, pjesëtarët e familjes përkufizohen si:

- bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëshorti/ja ose ish bashkëjetuesi/ja;
- vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
- bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i/e personave të parashikuar në pikën e dytë);
- gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
- vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit;
- fëmijët e bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es (neni 3, pika 3).

A ka më shumë se një lloj urdhër mbrojtjeje?

Ka dy lloje urdhrash mbrojtjeje:

Urdhër mbrojtjeje (nenet 10, 17).

Urdhri i mbrojtjes është një urdhër që lëshohet me vendim gjykate dhe përcakton disa masa mbrojtjeje për viktimën e dhunës në familje. Ky lëshohet pas një seance dhe pasi vërtetohet se (a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi mund të kryejë ndonjë akt të dhunës në familje; (b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës.

Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje (nenet 18, 19).

Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes është një urdhër gjykate i lëshuar përkohësisht, i vlefshëm deri në lëshimin e një urdhri mbrojtjeje të rregullt. Ai lëshohet në të njëjtat kushte, vetëm se gjykata ka 48 orë në dispozicion për të marrë një vendim pas parashtrimit të kërkesës. Ligji parashikon se duhet përcaktuar një datë për vërtetimin e urdhrin, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij. Dhunuesi ka vetëm 5 ditë kohë për ta ankimuar vendimin.

Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje?

- Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - vetë viktimia;
 - përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - policia/prokuroria (neni 13, pika 1).
- Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:
 - prindi ose kujdestari i të miturit;
 - përfaqësuesi ligjor ose avokati i të miturit;
 - të afërmit e të miturit;
 - përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm i mituri, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (neni 13, pika 2).

- Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - vetë viktimia;
 - përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - policia/prokuroria;
 - personi me të cilin viktimia ka marrëdhënie familjare;
 - përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (neni 13, pika 3).

Çdo person që është dëshmitar i dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme (neni 9).

Funksionet e prokurorit parashikohen në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale (KPrP) dhe nuk e përmbajnë këtë lloj ndërhyrjeje. Megjithatë, sipas nenit 59, pika 2 të KPrP-së prokurorët marrin pjesë në gjykimin e çështjeve me të dëmtuar akuzues dhe janë të pranishëm në çështje familjare, kështu që ky ligj do të jetë një autorizim i mjaftueshëm për praninë e tyre, nëse kjo prani është e nevojshme. Momenti i vetëm kur prokurorët kanë të ngjarë të bëjnë një kërkesë-padi është kur ata tashmë merren me një çështje dhe janë duke e ndjekur atë nga afër, p.sh., kur ata merren me një çështje penale, e cila ka të bëjë me këtë familje.

Kush mund t'i lëshojë urdhrat e mbrojtjes?

Gjykatat që mund të lëshojnë një urdhër mbrojtjeje janë gjykatat civile, seksioni familjar (neni 12).

Neni 349 i Kodit të Procedurës Civile (KPrC) parashikon kompetencat e gjyqtarëve në rastet e mosmarrëveshjeve familjare, të cilat janë aq të gjera sa mund të përfshijnë edhe urdhrat e mbrojtjes, meqënëse ato lidhen me pronën dhe kujdestarinë. Neni 138 i Kodit të Familjes lejon bashkimin e kërtimeve të tjera dhe neni 139 lejon marrjen e masave të përkohshme. Ajo që ka më tepër rëndësi është se edhe nëse nuk ka kërkesë-padi për urdhër mbrojtjeje, gjykata ka detyrimin që rrjedh nga neni 2 i Kodit të Familjes të kërkojë marrjen e masave për të parandaluar dëmtimin e fëmijëve. *Disa gjyqtarë gjykojnë se ky nen nuk zbatohet më që nga miratimi i Kodit të Familjes. Megjithatë, Kodi i Familjes nuk trajton procedurën, juridiksionin apo autoritetin gjyqësor.*

Neni 62 i Kodit të Familjes “Masat kundër dhunës” thotë:

Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore.

Pra, gjykata duhet t'i sugjerojë viktimës që ajo të kërkojë një urdhër mbrojtjeje ose, për t'i kursyer kohë gjykatës, thjesht të lëshojë një urdhër në bazë të detyrimeve të parashikuara në nenet 2 dhe 62 të Kodit të Familjes.

Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet pranë komisariatit më të afërt të policisë (neni 14, pika 2). *Kjo procedurë duhet të përdoret vetëm kur gjykata nuk është e disponueshme apo është shumë larg.* Policia duhet të veprojë në përputhje me nenet 104-108 të ligjit nr. 9749, datë 4 qershor 2007, “Për policinë e shtetit”. Neni 104 e lejon policinë të urdhërojë një person të largohet nga vendndodhja ose ta ndalojë atë të hyjë në një ambient, nëse ai paraqet kërcënim apo shqetësim. Neni 106 lejon policinë të marrë masa mbrojtëse nëse një person paraqet kërcënim për sigurinë e tij ose të personave të tjerë. Armët mund të bllokohen ose sekuestrohen në përputhje me nenin 108 (shih shtojcën B).

Cilat janë afatet kohore për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje?

Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë (neni 14, pika 2). Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës (neni 16). Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orësh pas parashtrimit të kërkesës (neni 18). Zhvillimi i çdo lloj procesi tjetër gjyqësor nuk ndikon në vendimin për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (neni 17, pika 2).

Çfarë lloje urdhrash mund të lëshohen?

Më poshtë jepen llojet e masave mbrojtëse që mund të lëshohen për të mbrojtur viktimën/at (neni 10):

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje në zbatim të këtij ligji do të sigurohet me këto mënyra:

- a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
- b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
- c) duke larguar menjëherë të paditurin (dhunuesin) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;
- ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
- d) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'u afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm apo të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimja, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
- dh) duke vendosur menjëherë viktimën dhe të miturit në strehime të përkohshme duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;
- e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;
- ë) duke i ndaluar të paditurit (dhunuesit) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të

- viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të zotërimit të dhunuesit;
- f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbarues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin (dhunuesin) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;
 - g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;
 - gj) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të lejojë viktimën të zotërojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktima dhe dhunuesi ose ndonjë pjesë të saj;
 - h) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;
 - i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;
 - j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit (dhunuesit) (kjo duhet krahasuar me kujdes me dispozitat e Kodit të Familjes- kjo diskutohet edhe më poshtë);
 - k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private pranë vendbanimit të viktimës apo pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje (kjo nuk duhet bërë kurrë pa pëlqimin e viktimës, sepse shpesh është e rrezikshme);

- l) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi (i dhunuesit) në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;
 - ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;
 - m) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i padituri urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i padituri (dhunuesi) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të KP-së, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.
2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në paragrafin e parë.
 3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri “g” të këtij neni.
 4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g” të këtij neni, gjykata mban parasysh:
 - a) nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrin të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata;
 - b) nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjykata njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Gjykata duhet të tregohet e kujdesshme që të mos japë zgjidhje që nuk ekzistojnë, p.sh., pjesëmarrje në një program rehabilitimi. Gjyqtarët duhet të mbahen të informuar për shërbimet që ekzistojnë në komunitet në mënyrë që të lëshojnë urdhra të përshtatshëm. Nëse i padituri urdhërohet nga gjykata të ndjekë një program rehabilitimi, programi duhet të plotësojë disa kërkesa (Shih faqet 37-41). Ndërmjetësimi është një masë krejtësisht e papërshtatshme, duke qenë se ai mund të jetë efikas vetëm nëse kryhet vullnetarisht. Po kështu, pajtimi dhe ballafaqimi (nenet 158/b dhe 240 të KPrC-së) janë të papërshtatshëm në çështjet e dhunës në familje.

Gjyqtarët duhet të tregohen të kujdesshëm që të mos urdhërojnë zgjidhje që nuk janë efektive si p.sh., trajtim për abuzim me alkoolin apo drogat. Këto nuk janë shkaqet e dhunës në familje dhe, si rrjedhojë, nuk janë as zgjidhja e saj. (Shih më poshtë faqen 41, ku diskutohen qasjet e ndryshme për trajtimin e dhunuesit).

Nëse i padituri lejohet të shkojë në banesë dhe të mbledhë sendet e tij, ai duhet të shoqërohet nga një punonjës policie ose punonjës i zyrës së përmbarimit. (Formulimi specifik i këtyre urdhrave jepet në shtojcën C)

Nëse është duke u kryer shkurorëzimi apo janë lëshuar urdhrat e përkohshëm, urdhrat duhet të jenë të pajtueshëm. Por në rast se ka ndryshime ndërmjet dy urdhrave, meqënëse urdhri i mbrojtjes lidhet me sigurinë e viktimave të dhunës, ai ka përparësi mbi urdhrat e gjykatës të cilat lëshohen në bazë të Kodit të Familjes. Palët duhet të paraqiten në gjykatë për të zgjidhur kontradiktat ndërmjet këtyre vendimeve. Por deri atëherë, urdhri i mbrojtjes ka përparësi (neni 17, pika 2).

Nëse janë sekuestruar, policia do t'i kthejë ato vetëm pasi të ketë përfunduar afati i urdhrimit të mbrojtjes dhe pasi të ketë marrë një urdhër nga gjykata ku thuhet se armët duhet të kthehen. Pasi të sekuestrojë armën, gjykata duhet të pezullojë ose anullojë lejen për mbajtjen e armës deri në përfundimin e afatit të urdhrimit të mbrojtjes ose deri në një vendim të dytë. Nëse personi është ushtarak ose punonjës policie duhet të njoftohet autoriteti administrativ, i cili duhet të ndërmarrë masa të mëtejshme.

Çfarë duhet të përmbajë kërkesë-padia?

Kërkesë-padia duhet të përmbajë elementët e nenit 154 të KPrC-së si dhe informacion shtesë për lidhjen mes viktimës dhe dhunuesit. Ajo duhet të përmbajë faktet, arsyen pse kërkuesi ka frikë për mirëqënien e tij, cilat masa mbrojtëse kërkohen dhe firmën e kërkuesit (neni 14).

Ku paraqitet kërkesë-padia?

Kërkesë-padia mund të paraqitet në çdo kohë në gjykatat e rrethit (seksioni familjar, aty ku ka një të tillë). Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet pranë komisariatit më të afërt të policisë (neni 14, pika 2) dhe policia duhet të veprojë sipas ligjit nr. 9749, datë 4 qershor 2007, "Për policinë e shtetit".

Për hartimin e kërkesë-padisë dhe paraqitjen e saj në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas (neni 14, pika 3). Por nëse nuk e ka një të tillë, kërkuesi mund të plotësojë një formular kërkesë të gatshëm ose ta shkruajë me dorë atë (Shtojca Ç). Kërkuesi nuk duhet të paguajë taksat e gjykatës për të paraqitur

kërkesën. *Punonjësit e gjykatës duhen udhëzuar saktë se ata duhet ta pranojnë kërkesën pa pagesë paraprake.* Nëse kërkesa pranohet nga gjykata, tarifat mund t'i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë. Nëse kërkesa refuzohet, tarifat mund t'i ngarkohen kërkuarit (neni 14, pika 4).

Kur do të zhvillohet seanca?

Për lëshimin e një urdhri të zakonshëm mbrojtjeje, gjykata duhet të caktojë një seancë brenda 15 ditësh (neni 16).

Për një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata duhet të marrë vendim brenda 48 orëve (neni 18). *Mosfunksionimi i sistemit postar nuk është një arsye e mjaftueshme për të shtyrë seancën. Kërkohet vetëm që procedura e thirrjes të kryhet, dhe jo që i padituri të paraqitet. Nëse i padituri nuk është dakord me urdhrin, ai ka mundësi të bëjë ankim.*

Cilat prova mund të pranohen në gjykatë?

Prova të nevojshme mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë, si p.sh. organizata jofitimprurëse (OJF) të regjistruar sipas dispozitave në fuqi (neni 15).

Duhet përdorur Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) për të gjetur nëse është lëshuar një urdhër arresti për dhunuesin, nëse ai është dënuar më parë ose nëse janë lëshuar urdhra mbrojtjeje ndaj tij.

Ruajtja e sekretit është mjaft e rëndësishme për një viktimë të dhunës. Shumë viktima nuk kërkojnë ndihmë pasi kanë frikë se gjithçka do të bëhet publike. Si rrjedhojë, duhen zbatuar me rreptësi dispozitat për ruajtjen e sekretit (nenet 59, 159, 282-289 të KPrP-së dhe neni 235 i KPrC-së).

Gjykata duhet të tregojë shumë kujdes në caktimin e ekspertit në çështjet e dhunës në familje. Ka shumë pak punonjës socialë, psikologë dhe personel tjetër mjekësor që kanë njohuri për dhunën në familje. (Shih “Vlerësimin e Kapaciteteve të Punonjësve të Kujdesit Shëndetësor për të Trajtuar Problemet Gjinore”, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë, UNICEF, Tiranë, 2006). Neni 224/a i KPrC-së parashikon që eksperti të ketë njohuri të posaçme në fushat për të cilat thirret të dëshmojë (nenet 224/a - 224/ç i KPrC-së). Dhuna në familje është një fushë njohurish shumë e specializuar dhe gjykata duhet të sigurohet që eksperti të ketë përgatitjen dhe përvojën e specializuar në këtë fushë.

Kush mund të dëshmojë në seancë?

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:

- viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
- dhunuesin, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij;
- prokurorin, nëse ka bërë kërkesë;
- përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë ku ka banim të përhershëm ose të përkohshëm personi i përmendur kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;

- punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të rehabilitimit të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës;
- dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm (nenet 16, 18).

Në bazë të nenit 235 të KPrC-së bashkëshortët ende të pandarë, fëmijët, prindërit dhe të afërmit e tjerë nuk mund të pyeten si dëshmitarë, me përjashtim të rastit kur çështja ka lidhje të drejtpërdrejtë me problemet familjare, si në rastin e dhunës në familje.

Po nëse seanca është për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes?

Ndryshimi i vetëm është se në përfundim të seancës, gjykata vendos anulimin si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin, pasi ai nuk arrin të provohet. Gjukata mund të lëshojë një urdhër mbrojtjeje dhe mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë (neni 20).

Kur duhet ta lëshojë gjykata urdhrin e mbrojtjes?

Gjukata lëshon urdhrin nëse vendos se ka të dhëna të mjaftueshme për të menduar se dhunuesi mund të kryejë një akt të dhunës në familje ose se lëshimi i urdhrin të mbrojtjes është i nevojshëm për garantimin e sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes. Urdhri lëshohet vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi (neni 17, pika 1).

Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj (neni 11 dhe neni 17 pika 2).

Është përgjegjësi e gjykatës të sigurojë që personat të marrin dijeni për akte të dhunës në familje dhe që nuk veprojnë në zbatim të këtij ligji, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale sipas nenit 248 ose 251 të KP-së (neni 8, pika 5).

Çfarë përmban vendimi?

Përveç sa përcaktohet në nenin 310 të KPrC-së, vendimi përmban edhe (neni 17, pika 3):

- a. masën e caktuar nga gjykata;
- b. kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;
- c. një njoftim se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të KP-së;
- ç. një njoftim për të drejtën e ankimit brenda 15 ditëve.

Vendimi për lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje përmban edhe (neni 19, pika 3):

- a. masën e caktuar nga gjykata;
- b. kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;
- c. një njoftim se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të KP-së;
- ç. njoftimin se koha e ankimit të vendimit është 5 ditë;

- d. datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

A ka procedurë për ankimim, ndryshim apo ndërprerje?

Vendimi për urdhrin e mbrojtjes ankimohe brenda 15 ditësh (neni 17, pika 3 (ç)). Vendimi për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ankimohe brenda 5 ditësh (neni 19, pika 3 (ç)). Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes (neni 21, pika 3).

Mënyra e vetme për të ndryshuar apo ndërprerë urdhrin është paraqitja e një ankimi. Sjellja e palëve apo ndonjë marrëveshje ndërmjet tyre nuk mund ta ndryshojë urdhrin e gjykatës. Nëse rrethanat ndryshojnë rrënjësisht, viktima, përfaqësuesi i saj ose prokurori që bën kërkesë, mund të paraqesë një kërkesë për ndërprerjen ose ndryshimin e urdhrin (neni 22). Kërkesa shqyrtohet njësoj si urdhri i mbrojtjes me seancë, prova dhe dëshmi (neni 22, pika 5). Parashtrimi i ankimit nuk e pezullon urdhrin e mbrojtjes, i cili mbetet në fuqi (neni 22, pika 3). Pas seancës, gjykata mund ta lërë urdhrin e mbrojtjes në fuqi, ta ndryshojë nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, ose ta ndërpresë nëse masat e mbrojtjes që parashikon ligji nuk nevojiten për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave. Gjykata duhet të tregojë mjaft kujdes kur është *paditësi* që kërkon ndryshimin apo ndërprerjen e një urdhri pasi mund të jetë dhunuesi, i cili e kanos viktimën për ta tërhequr urdhrin. Në rast se kërkesë-padia është ngritur nga policia ose prokuroria, vullneti i viktimës për t'u tërhequr nuk ka efekt (neni 13, pika 4 dhe neni 16, pika 3).

Urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij, nëse viktimi nuk kërkon vazhdimin e tij 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit (neni 22, pika 4). Më pas gjykata vendos mbi bazën e një kërkesë të zhvillojë një seancë, të marrë prova dhe dëshmi. Pas seancës, gjykata mund të vendosë për ndërprerjen e urdhrin në datën fillestare ose për vazhdimin e tij nëse ka arsye për të besuar se dhunuesi mund të kryejë një akt të dhunës në familje dhe se urdhri është i nevojshëm për mbrojtjen e viktimës.

Kush njoftohet pasi lëshohet urdhri?

Urdhri i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjykate hyn në fuqi menjëherë dhe fillon të zbatohet ndaj dhunuesit pavarësisht nëse ka marrë dajeni ose jo. Urdhri i mbrojtjes i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore (neni 17, pika 4-5 dhe neni 19, pika 4-5). Brenda 24 orëve, gjykata u dërgon kopje të urdhrin të mbrojtjes:

- a. viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
- b. prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;
- c. zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimi dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- ç. komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimi dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Kur hyn në fuqi urdhri?

Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv që në

momentin që shpallet dhe ekzekutohet menjëherë konform dispozitave të nenit 510 e vijues të KPrC-së (neni 23, pika 2). Gjykata duhet të lëshojë një urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511 të KPrC-së në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e mbrojtjes për të lehtësuar zbatimin dhe për të kursyer kohë dhe energji për viktimën dhe gjykatën (neni 19, pika 6 dhe neni 23, pika 1 dhe 2).

Kush ka detyrimin për ta ekzekutuar urdhrin?

Urdhri duhet të ekzekutohet menjëherë nga përmbaruesit, komisaritet e policisë dhe dhunuesi (neni 23, pika 2, 3 dhe 5). Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura.

Informacioni që një urdhër mbrojtjeje është lëshuar duhet të hidhet në bazën e të dhënave të TIMS-it ose të hidhet në një sistem ekzistues të dhënash në mënyrë që efektivat e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët të kenë dijeni për ekzistencën e urdhrin për të garantuar mbrojtjen e viktimës.

Çfarë ndodh nëse shkelet një urdhër mbrojtjeje?

Zyra e Përmbarimit do të kryejë ekzekutimin e detyruar të vendimit të gjykatës. Nëse dhunuesi nuk pranon të bindet vullnetarisht, autoritetet mund të kryejnë zbatimin/ekzekutimin e detyruar sipas nenit 606, paragrafi 3 të KPrC-së ose nenit 320 ose 320/a të KP-së. Nëse dhunuesi nuk pranon ta zbatojë urdhrin, përmbaruesi mund të kërkojë caktimin e një gjobe prej 50,000 lekësh në bazë të nenit 606, paragrafi 3 të KPrC-së. Nëse dhunuesi ndërhy

apo pengon ekzekutimin e urdhrit, përmbaruesi ka detyrimin të njoftojë prokurorin, i cili mund të zbatojë nenin 320 ose 320/a të KP-së. Për më tepër, policia dhe prokurori mund të nisin procedim penal përsa u përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepra penale (neni 23, 24).

Nëse dhunuesi ka kryer një vepër penale, justifikimi që ai nuk ishte në gjendje të kontrollonte veprimet e tij nuk shërben gjithmonë si arsye për ta liruar atë nga përgjegjësia penale. Megjithatë, personi nuk përgjigjet penalisht nëse, në kohën e kryerjes së veprës penale, diagnostikohet me një çrregullim mendor, për shkak të të cilit nuk është në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë pasojat e tyre. Në këtë rast gjyqtari mund të urdhërojë dërgimin e tij në një spital psikiatrik. Në qoftë se çrregullimi mendor i diagnostikuar ka ulur ekuilibrin e tij mendor, duke mos e prishur tërësisht aftësinë mendore të dhunuesit, kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit (neni 17 i KP-së). Personi që ka kryer veprën penale në gjendje të dehur ose nën ndikimin e ndonjë droge nuk përjashtohet nga përgjegjësia (neni 18 i KP-së), por nëse dehja është shkaktuar në rrethana të rastit (që sigurisht ndodh shumë rrallë) ajo mbahet parasysh në zbutjen e dënimit. Nëse dehja është bërë me paramendim, kjo shërben si rrethanë rënduese. Dhuna në familje është një vepër e rëndë dhe duhet dënuar më ashpër. Kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzana ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen (neni 50, gërma “e” i KP-së); ose kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare (neni 50, gërma “g” i KP-së).

Roli i veçantë i gjykatave për t'i dhënë fund dhunës në familje

Për një çështje të dhunës në familje, ka pak gjëra më të rëndësishme se mënyra si sillet gjykata gjatë zhvillimit të procedimit ligjor. Mënyra me të cilën sillet personeli i gjykatës dhe vetë gjykata, jep një mesazh të rëndësishëm për njohjen e rëndësisë së të gjitha aspekteve të dhunës në familje.

Dhënia e drejtimit

Është thelbësore që gjyqtarët dhe stafi i tyre t'u japin drejtim të gjitha procedimeve. Formularë për paraqitjen e kërkesës për urdhër mbrojtjeje dhe për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje janë hartuar dhe mund t'i gjeni bashkangjitur si shtojcat Ç-DH. Kuvendi e ka shprehur qartë në ligj se dëshiron procedura të shpejta, të pakushtueshme dhe të thjeshta për viktimat. Garantimi i formularëve është një mënyrë për ta zbatuar ligjin. Personeli i gjykatës duhet t'ua ofrojë këto formularë viktimave falas. Edhe pse personeli i gjykatës mund të mos ofrojë këshillim apo ndihmë ligjore, ai mund të japë këto formularë.

Çështjet duhen trajtuar dhe zgjidhur menjëherë. Vendimi për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes duhet marrë brenda 48 orëve dhe për urdhrat e mbrojtjes brenda 15 ditëve. Në rastet e dhunës në familje vihet në rrezik jeta dhe siguria e njerëzve. Këto kërkesa duhen shqyrtuar menjëherë - prandaj edhe ligji i jep kërkuarit të drejtën për të paraqitur kërkesë në çdo kohë në gjykatë. Gjykata duhet ta shqyrtojë çështjen në mënyrë të thellë. Sjellja dhe qëndrimi i gjykatës dhe e personelit ndihmës duhet të pasqyrojë rëndësinë e situatës. Kujdes i duhet kushtuar ndarjes

fizike të palëve, duke përfshirë këtu edhe familjarët dhe miqtë, për të parandaluar shtrëngimet dhe kërcënimet.

Spektatorët dhe dëshmitarët

Ndodh që të dyja palët të shoqërohen nga dëshmitarë, miq dhe përkrahës. Shpesh këta persona janë drejtpërdrejt të interesuar apo të përfshirë në procedim. Shpesh dhunuesin e shoqëron një partner i ri. Ndërkohë, kërkuesi është shpesh i shoqëruar nga avokati që mbron të drejtat e viktimave. Duhet marrë masa për të vendosur rregulla bazë për sjelljen e të gjitha palëve. Gjykata mund të lërë jashtë dëshmitarët e ardhshëm, si dhe t'i ndalojë ata të komunikojnë me njëri-tjetrin (neni 237 i KPrC-së).

Gjykata këshillohet që ta fillojë seancën duke deklaruar se shpërthime dhe shprehje të fytyrës apo gjeste të mosbesimit apo inatit si p.sh., kapsallitje sysh dhe psherëtima, nuk do të tolerohen. Nëse gjyqtari vëren një sjellje të tillë, ai do të ndërpresë seancën, do ta qortojë personin dhe ta njoftojë atë se në rast të përsëritjes së kësaj sjelljeje ai do të largohet nga salla e gjyqit (neni 178 i KPrC-së). Në rast se ndodh përsëri, këshillohet që gjyqtari ta largojë personin nga gjykata. Efekti ka mundësi të jetë i menjëhershëm.

Viktimat

Shpesh kërkuesi mbërrin në gjykatë së bashku me dhunuesin. Duhet treguar mjaft kujdes për të ndaluar që dhunuesi të ndikojë mbi apo të frikësojë kërkuesin. Zakonisht godinat e gjykatave janë të mbushura me njerëz dhe palët janë shpesh pranë njëra-tjetrës. Gjykata duhet të marrë masa për të ndarë palët sa më shumë të jetë e mundur dhe për të vendosur persona ndërmjet tyre, si p.sh., avokatët apo përmbaruesit.

Gjykata duhet të ketë kujdes edhe për shikimet e zemëruara apo kërcënuese që dhunuesi mund t'i hedhë kërkuesit. Nëse gjyqtari vë re këtë lloj sjelljeje, ai duhet ta përmendë këtë me qëllim që të mbahet shënim, si dhe ta paralajmërojë dhunuesin të mos e përsërisë. Në të kundërt, ai do të ndëshkohet për thyerje të rregullit dhe të qetësisë në seancën gjyqësore (neni 178 i KPrC-së).

Shumë viktimat të dhunës në familje hezitojnë të dëshmojnë kundër dhunuesve të tyre. Viktimat mund të hezitojnë për arsyet e mëposhtme:

- Viktima mund të jetë e pakënaqur me sistemin gjyqësor. Kjo mund të ndodhë pasi viktimat nuk është e përgatitur për procedurat e ndërlikuara gjyqësore ose pasi punonjësit e gjykatave e kanë bërë viktimën të ndihet përgjegjëse për dhunën.
- Viktima mund t'i nënshtrohet kanosjes ose frikësimit nga dhunuesi.
- Siç ndodh edhe me Sindromën e Stokholmit, dhunuesi mund të jetë duke u sjellë mirë me viktimën në këtë moment. Duke shpresuar se kjo gjendje do të vazhdojë, viktimat nuk pranon të marrë pjesë.
- Shumë viktimat fajësojnë plotësisht apo pjesërisht veten për dhunën.
- Viktima mund të jetë duke e përdorur procesin si një përpjekje tjetër për ta bindur dhunuesin të ndalë dhunën. Studimet tregojnë se viktimat provojnë metoda të ndryshme për të ndaluar dhunën.
- Edhe kur gratë viktimat dëshmojnë, fjalët e tyre shpesh nuk besohen. Shumë studime në të gjithë botën tregojnë se gjyqtarët nuk e marrin parasysh dëshminë e gruas për dhunën.
- Përgjithësisht, viktimat dhe dhunuesit janë dëshmitarët e

vetëm okularë. Por gjykata e di se dëshmia e dëshmitarëve okularë nuk është e besueshme. Kjo është edhe arsyeja se përse në juridiksionet moderne i vihet shumë më tepër rëndësi llojeve të tjera të provave.

- Urdhrat e mbrojtjes janë vendime të gjykatës ndaj dhunuesit për sjellje që nuk lejohen. Si të tilla, ato nuk mund të ndryshohen me marrëveshje mes palëve apo të ndryshohen nga vetëm njëra prej palëve. Për më tepër, në urdhër nuk trajtohet viktima, pasi ajo nuk është personi që ka kryer veprimin e ndaluar (neni 17).
- Hetimet në rastet e dhunës në familje kërkojnë po aq prova sa ato të çështjeve të tjera. Gjykata thjesht duhet të kuptojë dinamikën e dhunës në familje dhe të njohë ligjet, ashtu si për çdo çështje tjetër. Vdekshmëria është mjaft e lartë në çështjet e dhunës në familje dhe veprimet e menjëhershme të gjykatës janë shumë të rëndësishme për të parandaluar krime më të rënda.

Çështjet etike

Edhe pse gjyqtari duhet të mbajë gjithmonë një rol të paanshëm për pozicionin e tij, kjo nuk e ndalon atë të kujdeset për sigurinë e të gjithë personave. Po kështu, gjyqtarët kanë detyrimin për të njohur dhe kuptuar dinamikën dhe ligjet që lidhen me dhunën në familje, ashtu si njohin edhe ligjet e tjera.

Siguria në gjykatë

Gjykata duhet të marrë të gjitha masat për të minimizuar kontaktet ndërmjet paditësit dhe të paditurit. Kur përfundon seanca, i padituri duhet mbajtur në sallën e gjyqit për 15 minuta, ndërkohë që paditësi shoqërohet nga një punonjës policie jashtë sallës së gjyqit, deri tek mjeti i transportit.

Në çdo kohë, gjykata ka detyrimin të garantojë sigurinë për punonjësit e gjykatës dhe qytetarët. Një nëpunës gjyqësor mund të jetë i pranishëm gjatë gjithë seancës. Viktima ka të drejtë të trajtohet me drejtësi, respekt, dinjitet dhe pa u kanosur, ngacmuar apo abuzuar gjatë gjithë procedimeve.

Si mund të ndihmojnë gjyqtarët

Sjellja e gjyqtarit shpreh shqetësim për rrethanat e viktimave dhe për ngjarjet që po zhvillohen. Gjyqtari duhet të kuptojë se viktima mund të ndihet e dërrmuar nga procesi dhe mund të mos jetë në gjendje t'i ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm. Me qëllim që të ushtrojë drejt funksionet e tij, gjyqtari duhet të mbajë parasysh ç'shkruhet më poshtë:

- Gjyqtari duhet të dëgjojë me kujdes.
- Hapi i parë drejt ndërprerjes së dhunës është identifikimi i saj. Mohimi, arsyetimet dhe nënvleftësimi janë metoda të cilat viktima dhe personat afër saj i përdorin shpesh, për t'i bërë ballë situatës. Gjikata duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndihmuar viktimën të ndihet e sigurt.
- Viktima duhet t'i besojë gjyqtarit. Një prej efekteve të dhunës është se ajo shkatërron aq shumë ndjenjën e besimit tek viktima sa që ajo nuk mund të besojë më të askush. Një gabim në gjykim mund të jetë një gabim vdekjeprurës për viktimën. Gjikata duhet të mbajë një qëndrim aktiv në mënyrë që viktima të ketë besim tek gjykata dhe tek procesi. Nëse viktima nuk ka avokat, duhet t'i cakohet një nga gjykata (neni 14(3)).

- Ndërkohë që viktima mund t'i kuptojë çështjet ligjore, ajo mund të jetë duke përjetuar një gjendje të atillë emocionale, e cila e pengon të kuptojë mundësitë e saj. Gjyqtari duhet t'i shpjegojë me kujdes mundësitë dhe të sigurohet që viktima i kupton ato.
- Viktima mund të mos dëshirojë të krijojë probleme dhe mund të shfaqet shumë e kënaqur edhe kur nuk është dakord. Gjyqtari duhet të gjejë kohë për të pyetur për detaje specifike. Viktima mund të jetë e prirur që, për shkak të frikës së dhunës së mëtejshme, të pranojë përgjegjësi në lidhje me ato për të cilat nuk ka faj. Shpesh, viktima mund të pranojë që të mbahen shënim pasaktësi, për të njëjtat arsye. Gjyqtari duhet të sigurohet se ato që po mbahen shënim janë të qarta dhe të plota. Viktima duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë pa frikë dhe, nëse është e nevojshme, pa praninë e dhunuesit.
- Salla e gjyqit duhet të jetë e zhveshur nga kanosjet. Është e lehtë të harrohet se viktima mund të jetë përballur me kërcënime për vite me rradhë. Gjykata duhet të krijojë një atmosferë në sallë që tregon se s'ka absolutisht tolerancë për dhunën në familje. Gjyqtari mund t'i udhëzojë punonjësit e ruajtjes së sigurisë të mos lejojnë biseda me zë të lartë apo sjellje kërcënuese gjatë pushimeve të seancës. Nuk duhet të lejohen komente për viktimën apo shaka. Nëse kjo do të lejohej, do të jepej një mesazh mosbesimi dhe do të tregonte se dhunuesi gëzon imunitet nga autoriteti i gjykatës (neni 178 i KPrC-së).

Ruajtja e sekretit

Çështja e të drejtave dhe detyrave të stafit të një programi të dhunës në familje si dhe atij mjekësor, që mund të ketë trajtuar një

viktimë të dhunës në familje, është ngritur shpesh në vendet e tjera. Dispozitat për ruajtjen e sekretit gjenden në nenet 59, 159, 282-284 të KPrP-së dhe nenit 235 të KPrC-së. Ruajtja e sekretit është shumë e rëndësishme për viktimën. Veçanërisht ruajtje e sekretit për adresën e saj të re apo adresa e personave që e ndihmojnë, duke qenë se këta të fundit vihen në shinjestër nga dhunuesi, me qëllimin për ta penguar viktimën të shfrytëzojë mundësitë e saj.

Praktikat më të mira për të ndaluar dhunën në familje

Dhuna në familje është një sjellje që mësohet nëpërmjet vëzhgimeve, përvojës, përsëritjeve, kulturës, familjes dhe komunitetit. Ajo shkaktohet rrallë nga gjenetika, abuzimi me drogat, sëmundjet apo problemet në marrëdhënie. Shumë dhunues besojnë se ata kanë të drejtë për të vendosur dhe për të imponuar rregulla. Shumë viktima vlerësojnë cilat rregulla të respektojnë, nisur nga niveli i rrezikut, ndërhyrjet e mundshme dhe mundësia e ndëshkimit të dhunuesve të tyre.

Dhuna në familje ka të bëjë me pushtetin dhe kontrollin. Dhuna është një zgjedhje, jo një sjellje “jashtë kontrolli”. Ndërprerja e dhunës kërkon një reagim të ri që merr në konsideratë dinamikën unike të dhunës në familje. Efektet që ajo jep zakonisht tek viktimat janë vetëbesim i ulët, vetëfajësim, stres, fajësim, vetëmjekim nëpërmjet alkoolit apo drogave, ide për vetëvrasje, izolim nga familja dhe miqtë, nënvleftësim apo arsyetim i dhunës dhe kryesisht frikë. Sjelljet e zakonshme të dhunuesit përfshijnë: përpjekje të vazhdueshme për të kontrolluar viktimën, nënvleftësim të dhunës, mohim të veprimeve, fajësim të viktimës, vetëvlerësim të ulët, xhelozia dhe ndjenjë pronësie, kërcënime, varësi nga viktima, shfaqje të pranueshme madje edhe të pëlqyeshme në publik, por një sjellje krejtësisht e ndryshme në shtëpi, abuzim me drogat, premtime se nuk do të

ndodhë më kurrë dhe shprehje të një keqardhjeje që nuk e ndien në të vërtetë.

Qëllimet për të cilat lëshohet urdhri i mbrojtjes janë:

- për të ndërprerë dhunën dhe për të mbrojtur viktimat;
- për t'i vënë dhunuesit përpara përgjegjësisë;
- për të ndryshuar sjelljen e dhunuesit;
- për të krijuar pasoja për shkeljen e vendimeve të gjykatës;
- për ta bërë të qartë se dhuna në familje nuk tolerohet nga shoqëria;
- për të parandaluar dhunën në brezat e ardhshëm.

Përgjegjësia e të paditurit

Siç u përmend më sipër, gjykata mund të përdorë nenin 606, pika 3 e KPrC-së, nenin 320 të KP-së si dhe shkelje të tjera të parashikuara nga dispozita penale, shkelje këto të cilat mund të kenë ndodhur kur urdhri i mbrojtjes është thyer, me qëllim që dhunuesi të mbajë përgjegjësinë e tij. Meqënëse ky është një krim i kryer në familje, dënimi duhet të jetë më i rëndë, siç parashikohet në nenin 50 të KP-së.

Për të përcaktuar metodat e duhura me qëllim që dhunuesi të mbajë përgjegjësi dhe të ndryshojë sjelljen e tij, gjykatave mund t'u duhet të njihen me disa fakte, të cilat renditen si më poshtë:

- Precendetët penalë të dhunuesit. Kjo e dhënë gjendet nëpërmjet sistemit TIMS, kur ai të bëhet funksional në të gjitha qarqet.
- Ndikimi i dhunës tek viktimat dhe dëshirat e viktimës.
- Historiku i sjelljes abuzive.

- Kontrolle për drogë, alkool dhe gjendjen e shëndetit mendor.
- Kontakte të shkuara të familjes me gjykatën.
- Informacion për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në të njëjtën banesë.
- Vlerësimi i rrezikut për jetën. Për të parashikuar rrezikshmërinë kanë qenë të dobishëm këta faktorë:
 - A po përpiqet viktimja për të ndarë apo shkurorëzuar dhunuesin? Nëse po, kjo e rrit rrezikun.
 - Përdorimi i drogës apo alkoolit nuk shkakton dhunë, por shpesh rrit shkallën e dhunës dhe si rrjedhim, lëndimet ndaj viktimës.
 - Depresioni po kështu nuk shkakton dhunë, por mund të rrisë shkallën e saj.
 - Mundësia për të përdorur armë, veçanërisht armë zjarri, është shumë e rrezikshme.
 - Ndjekja është simptomë e obsesionit.
 - Zemërimi përdoret si arsye për të justifikuar sjelljen.
 - Obsesioni - Nëse nuk të kam unë, s'do të të ketë askush tjetër.
 - Kërcënimet për vrasje apo vetëvrasje duhen marrë seriozisht.
 - Mundësia për të takuar lehtë viktimat apo fëmijët - shpesh me rastin e vizitave të autorizuara nga gjykata.
 - Historiku i dhunës në familje - duke përfshirë dhunën ndaj kafshëve.
 - Izolim i cili ka ardhur duke u rritur.
 - Dhuna seksuale - shpesh i paraprin vrasjes.
 - Përshkallëzim i ndonjëres prej sjelljeve të mësipërme.

Programet e rehabilitimit të dhunuesit

Ekzistojnë programe të llojeve të ndryshme, me filozofi dhe praktika mjaft të ndryshme. Siguria e viktimës duhet të jetë shqetësimi kryesor dhe përgjegjësia e dhunuesit duhet të jetë në vend të dytë. Për ta bërë çështjen të qartë, duhet të theksohet se pjesa më e madhe e rasteve të dhunës në familje kryhet nga dhunues meshkuj ndaj viktimave femra. Në të gjithë botën, rreth 95% e dhunuesve janë meshkuj dhe 85% e viktimave janë femra. Në përqindjen e vogël të dhunueseve femra, një pjesë e madhe e tyre janë viktimat të dhunës në familje që e kanë përdorur dhunën për të mbrojtur veten apo pjesëtarët të familjes, veçanërisht fëmijët.

Megjithëse ka një shumëllojshmëri programesh, shumica e tyre kanë një proces të ngjashëm. Ato fillojnë me marrje informacioni dhe vlerësim, që ndiqet nga udhëzime dhe përcaktime të rregullave dhe detyrimeve. Shumë persona njihen me qëllimin themelor të programit. Dhunuesi ndjek seanca javore që përqendrohen tek edukimi, terapia apo tek të dyja bashkë për të identifikuar sjelljet e dhunshme, për ta përkrahur personin të pranojë dhunën dhe për ta atë motivuar të ndryshojë.

Disa programe mbajnë lidhje me viktimën për të siguruar përparime të pranishme, disa mbështeten tek avokatët e viktimave dhe disa të tjerë nuk kontaktojnë fare me viktimën. Kjo e fundit është e rrezikshme, pasi nuk ka një bazë faktike që të përcaktojë se sjellja e dhunuesit ka ndryshuar apo nuk ka ndryshuar. Kriteret për përfundimin e programit mund të renditen që nga thjesht pjesëmarrja te hartimi i një letre për mbajtjen e përgjegjësisë, apo te marrja e masave të tjera konkrete. Vetëm ndjekja e programit nuk siguron që sjellja të ketë ndryshuar në të vërtetë.

Ka tri kategori të mëdha të filozofisë së trajtimit. Analiza që nxjerr në pah ndryshimet në të treja kategoritë është pikërisht shkak i dhunës në familje.

- *Pro-feministe*: Filozofia pro-feministe sugjeron se për shkak se shoqëria jonë ka trashëguar në shekuj qendrite dhe besime të formuara nga ideja e epërsisë së burrave ndaj grave, shkak gjendet në shoqërizimin e burrave, si dhe tolerancën dhe përkrahjen e dhunës së meshkujve. Trajtimi përqendrohet në përbalimin dhe riedukimin e qëndrimeve dhe besimeve që përkrahin këtë sjellje. Dihet se kjo duhet të shoqërohet me një reagim të fortë të sistemit ligjor që tregon tolerancë zero ndaj dhunës në familje.
- *Qasja e sistemeve familjare*: Qasja e sistemeve familjare e vendos problemin në funksionimin e sistemit të familjes. Kjo i sheh të gjithë pjesëtarët e familjes si kontribues në këtë problem. Problemi i këtij modeli është se ka tendencën për të fajësuar viktimën dhe përqendrohet në këshillimin për çiftet që njihet si metodë e rrezikshme për viktimën, në rastin më të keq dhe si joefikase, në rastin më të mirë, pasi viktima nuk mund të shprehet lirisht për shkak të frikës nga hakmarrja. Kjo qasje përdoret më rrallë dhe duhet vëzhguar nga afër për të parandaluar rreziqe më të mëdha për viktimën.
- *Përqendrim në patologjinë individuale*: Kjo qasje e vendos problemin e abuzimit në përbërjen e individit. Çrregullimet e personalitetit dhe përvojat traumatike në fëmijëri shihen si shkaqe të dhunës në familje. Për të ndërhyrë përdoret një qasje psiko-dinamike ose perceptuale e sjelljes. Një nga anët negative të këtij këndvështrimi është që nuk është identifikuar asnjë “tip” psikologjik për të përshkruar,

shpjeguar apo parashikuar recidivizmin. Karakteristikat psikologjike të dhunuesve përfshijnë të gjithë spektrin po ashtu si edhe tek personat që nuk janë dhunues. Ndoshta si pasojë e kësaj, përqendrimi tani ka kaluar tek faktorët kulturorë dhe psikologjikë.

Deri tani nuk është vërtetuar efikasiteti i programeve të trajtimit për dhunuesit. Vetëm disa studime kanë zbuluar përmirësime të vogla si rrjedhojë e ndjekjes së këtyre programeve. Më tej, këto suksese bazohen vetëm në vetëraportimet e dhunuesve. Në rastet kur i është kërkuar viktimave të raportojnë sjelljen e dhunuesve, është vënë re se niveli i suksesit është më i ulët.

Femrat kanë raportuar se dhunuesit kanë mësuar t'i dhunojnë në një mënyrë më të sofistikuar në mënyrë që të mos bëhet dot kallëzim në polici. Një prokuror në Rusi tha "Përse duhet ta dhunosh një grua kur ka qaq mënyra të tjera për ta kontrolluar atë?" Për më tepër, ndërkohë që dhunuesit sistematikisht i zvogëlojnë veprimet e tyre gjatë pyetjes, viktimat janë vazhdimisht tepër optimiste për mundësinë që dhunuesi do të ndryshojë. Është gjithashtu mjaft e vështirë të vlerësosh shkallën e frikës që ndien viktimat dhe që mund të pengojë kallëzimin e dhunës.

Disa kritere të suksesit që duhet të kërkojë gjykata:

- dhuna merr fund;
- kanosjet dhe frikësimet marrin fund;
- viktimat janë dhe ndihen të sigurta;
- sjellja manipuluese merr fund;
- rritet sjellja e barabartë.

Një program trajtimi cilësor për dhunuesit duhet:

- të jetë i liçensuar;
- të ketë kontakte të rregullta me gjykatën;

- të ketë si përparësi sigurinë e viktimës;
- të ketë si përparësi të dytë përgjegjësinë e dhunuesit;
- të ketë kontakte me viktimën;
- të kuptojë këndvështrimin e pushtetit dhe kontrollit;
- të veprojnë në një sistem reagimi të koordinuar të komunitetit;
- të vazhdojnë të paktën për 26 javë, mundësisht për 52;
- të ketë ndihmës meshkuj dhe femra;
- të ketë një program të ndryshëm për dhunueset femra.

Një program trajtimi cilësor për dhunuesit iu mëson:

- ndërgjegjësim për taktikat e pushtetit dhe kontrollit;
- se vetëm dhunuesit janë përgjegjës për sjelljen e tyre;
- se viktima nuk është kurrë shkak i sjelljes së tyre;
- se askush nuk meriton të dhunohet;
- se askush nuk ka të drejtë të kontrollojë dikë tjetër;
- se partneri nuk është pronë;
- se dhuna është zgjedhje;
- se dhuna është metodë për të pasur pushtet dhe kontroll mbi dikë tjetër;
- se dhuna nuk është problem zemërimi, problem që vjen nga droga apo alkooli apo nga sëmundjet mendore.

Një program trajtimi cilësor për dhunuesit duhet të:

- sigurojë në gjykatë raporte periodike për sjelljen e dhunuesit;
- sigurojë kontakte të rregullta me viktimën dhe/ose avokatët që mbrojnë të drejtat e viktimave;
- takohet rregullisht me grupin e reagimit të koordinuar të komunitetit.

Nga përvoja me programet e trajtimit të dhunuesve të zbatuara në vendet e tjera janë përfituar disa mësimet të rëndësishme. Personi

nuk duhet urdhëruar kurrë të ndjekë kurse për administrimin e zemërimit, për përdorimin e zemërimit si mjet për manipulim dhe taktikë kontrolli, sepse kjo sjell shpërfilljen e dinamikës së gjerë të dhunës në familje. Administrimi i zemërimit mbështet gjithashtu mitin se dhunuesi “humbet kontrollin”. Vite përvoje tregojnë se nuk ndodh kështu. Dhunuesi zgjedh qartë se kur, ku dhe kë të dhunojë dhe mund të qetësohet shpejt kur policia troket në derë. Këshillimi i çifteve është kaq i rrezikshëm saqë mjaft shtete në botë e kanë ndaluar me ligj. Viktima përballet me rrezikun e hakmarrjes dhe këshillimi e vazhdon mitin se në njëfarë mënyre viktima është fajtores për dhunën dhe se ajo e fal sjelljen e dhunuesit.

Së treti, trajtimi nga droga ose alkooli mund të jetë i nevojshëm, por do të zgjidhte vetëm një pjesë të vogël të problemit. Dhunuesit e vazhdojnë sjelljen e tyre si në gjendje të dehur, ashtu edhe esëll. Droga ose alkooli mund të rrisë shkallën e dhunës, por nuk e shkakton atë; as ndërprerja e përdorimit të drogës ose alkoolit nuk e ndërpret dhunën në familje.

Së fundmi, një programi trajtimi i vetëm nuk mundet ta ndryshojë sjelljen e dhunuesit. Shumë përvoja i kanë mësuar dhunuesit se kjo sjellje është e pranueshme. Ndikimi i përbashkët i sistemit të drejtësisë penale dhe civile si dhe shoqërisë është i nevojshëm për të treguar të kundërtën. Vëzhgimi i dhunuesit nga gjykata ka treguar se ka një ndikim mjaft pozitiv në ndryshimin e sjelljes. Fjalët e gjyqtarëve kanë qenë efikase për të transmetuar mesazhin se nuk do të ketë asnjë lloj tolerance për dhunën në familje dhe për të treguar një mosmiratim të fortë shoqëror për aktet e dhunës. Sistemi gjyqësor është tepër i rëndësishëm për t'i dhënë zgjidhje dhunës në familje.

SHTOJCA



SHTOJCA A

LIGJ NR.9669, DATË 18.12.2006 “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i

¹ Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12 maj 2008, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”.

kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Neni 2

Objekti

Ky ligj ka si objekt:

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

3. “Pjesëtarë të familjes” janë:
 - a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
 - b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
 - c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;
 - ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
 - d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;
 - dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.
4. “Viktimë“ është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.
7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Neni 4

Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:
 - a) njësitë e qeverisjes vendore;
 - b) Ministria e Brendshme;
 - c) Ministria e Shëndetësisë;
 - ç) Ministria e Drejtësisë;
 - d) Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

- a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme, që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

- ç) organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale, që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
- d) mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;
- dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;
- e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;
- f) marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- g) marrjen e masave për krijimin e qendrave të rritjes së fëmijëve, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë, ose kur prindërit e tyre kryejnë vepra dhune ndaj njëri-tjetrit.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:
 - a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;
 - b) trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.
2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna:

- a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
 - b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
 - c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
 - ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
 - d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.
3. Ministria e Drejtësisë ka këto detyra:
- a) të trajtojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
 - b) të trajtojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23 pika 6, si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura;
 - c) të financojë mbrojtje ligjore falas, sipas parashikimeve në ligj dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar, që mund të japin një asistencë të tillë.
- 3/1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka këto detyra:
- a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;
 - b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
4. Njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë këto detyra:
- a) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;

- b) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
- c) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrave të mbrojtjes apo urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.
3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
 - a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
 - b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;

- c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;
 - ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.
 5. Personat të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.
 6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktima mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit, për të marrë masat e nevojshme.
2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet me këto mënyra:
 - a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
 - b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
 - c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;
 - ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
 - d) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

- dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;
- e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;
- ë) duke i ndaluar të paditurit/ës (dhunuesit) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;
- f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbarues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;
- g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;
- gj) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimë dhe dhunuesi ose ndonjë pjesë të saj;
- h) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;
- i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;
- j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit/ës (dhunuesit);

- k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;
 - l) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;
 - ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;
 - m) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i/e padituri/a (dhunuesi) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i i padituri/e paditura (dhunuesi) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.
2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.
 3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të këtij neni.
 4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g” të këtij neni, gjykata mban parasysh:

- a) nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrimit të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata;
- b) nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjykata njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Neni 11

Efektet e urdhrimit të mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.
2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar.

Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.
3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a) vetë viktimja;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) policia/prokuroria.
2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:
 - a) prindi ose kujdestari i të miturit;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) të afërmit;
 - ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara

nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a) vetë viktimja;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) policia/prokuroria;
 - ç) personi me të cilin viktimja ka marrëdhënie familjare;
 - d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 14

Forma e kërkesë-padisë

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:
 - a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;
 - b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a (dhunuesi) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;

- c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;
 - ç) nënshkrimin e kërkuesit.
2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin “Për Policinë e Shtetit”.
 3. Për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas.
 4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrat të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.
 5. Kërkesë-padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 15

Provat në procesin gjyqësor

1. Provat që duhet t’i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.
2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar

(kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:
 - a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
 - b) të paditurin/ën (dhunuesin), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
 - c) prokurorin/en, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
 - ç) përfaqësuesit e policisë;
 - d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
 - dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
 - e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:
 - a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;
 - b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.
2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor , ku përfshihet njëra prej palëve.
3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:
 - a) masën e caktuar nga gjykata;
 - b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;
 - c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me

- vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
- ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij.
4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:
- a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
 - b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;
 - c) zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
 - ç) komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.
2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:
 - a) viktimat, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;

- b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;
- c) prokurori, nëse merr pjesë;
- ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;
- d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:
 - a) ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose
 - b) i/e padituri/a (dhunuesi) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose
 - c) lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.
2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.
3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:
 - a) masën e caktuar nga gjykata;

- b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;
 - c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën veprë penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
 - ç) njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijëni e tij;
 - d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.
4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.
- Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njëri prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrin ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
5. Gjkata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:
- a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
 - b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;
 - c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
 - ç) komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.
6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përbarimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510/e, 516/c e vijues).

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata:

- a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;
- b) refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;
- c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21

Ankimi

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.
2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimi (përfaqësuesi i saj), dhunuesi ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes.
2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:
 - a) lënien në fuqi të urdhrit të mbrojtjes;
 - b) ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose
 - c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika 1 të këtij ligji nuk vlejnë më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.
3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.
4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.
5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:
 - a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrit të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose

- b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv që në momentin që shpallet (ose u njoftohet palëve). Gjykata lëshon një urdhër ekzekutimi në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.
2. Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbaruesit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisariatet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.
3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.
4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikura në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.
5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbarimor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues).
6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës, siç përshkruhet në pikat 2 dhe

4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin/ën, të cilëve u komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për moszekutimin e vendimit të gjykatës zbatohen sanksionet përkatëse të parashikura në nenet 320 e 320/a të Kodit Penal, si edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Procedimi penal

Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisnin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 25

Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr. 5182, datë 12 janar 2007, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

SHTOJCA B

LIGJI NR. 9749, DATË 4 QERSHOR 2007, “PËR POLICINË E SHTETIT”

(Pjesë)

Neni 104

Largimi nga vendndodhja

Për të shmangur kërcënimin ose shqetësimin për rendin ose sigurinë publike, punonjësi i Policisë mund të urdhërojë personin të largohet nga vendndodhja ose mund ta ndalojë atë të hyjë në një mjedis, për aq kohë sa ky kërcënim apo shqetësim vazhdon.

Neni 106

Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse. Në këto raste punonjësi i Policisë e shoqëron personin në mjediset e Policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit apo e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.
2. Punonjësit e Policisë marrin masat e nevojshme për mbrojtjen:
 - a) e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike apo rrezikim të jetës së tij apo të të tjerëve. Zbatimi i masës në mjediset e Policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë;

- b) e të miturit që nuk mbikëqyret më ose është larguar nga prindi apo kujdestari i tij, duke ia rikthyer kujdestarit apo duke e dërguar në qendrat e përkujdesit për të miturit, sipas afatit të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike.
3. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, punonjësi i Policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave.

Neni 108

Blokimi i sendeve

Sendet bllokohen ose sekuestrohen vetëm në rastet kur lejohet me ligj dhe në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike. Punonjësi i Policisë që vepron, harton procesverbalin e caktuar, i cili i jepet poseduesit nëse ai njihet.

Sendet bllokohen vetëm për aq kohë është e nevojshme. Pas kësaj, sendet i kthehen poseduesit nëse është identifikuar ose nëse identifikohet pa vonesë. Nëse brenda 90 ditëve, ose në një hark kohor më të shkurtër, siç mund ta kërkojë natyra e sendit, poseduesi i sendit nuk mund të identifikohet ose nuk kërkon me dëshirën e tij kthimin e sendit, sendi i bllokuar kalon në pronësi të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Policia ka përgjegjësinë të kryejë verifikime për identifikimin e pronarit të sendeve të bllokuara.

SHTOJCA C

SEANCA E URDRIT TË MBROJTJES

A. Betimi

Kryetari i seancës gjyqësore, pasi të jetë siguruar për identitetin e dëshmitarëve, i ndërgjegjëson ata për rëndësinë e misionit e të betimit përpara gjykatës dhe i njofton ata se janë të detyruar të tregojnë të vërtetën për atë që dinë në lidhje me çështjen dhe i paralajmëron për përgjegjësinë që kanë për dëshmi të rreme. Ndërkohë, sekretari gjyqësor lexon formulën e betimit si më poshtë: *“I ndërgjegjshëm, betohem se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën”*. Dëshmitari në këmbë përgjigjet *“Betohem”* dhe pret jashtë sallës së gjyqit me porosinë të mos merren vesh me njëri-tjetrin (neni 237 i KPrC-së).

Për t’u regjistruar, nëpunësi gjyqësor njofton emrat e palëve dhe numrin e çështjes.

Kjo është çështja numër _____, paditësi _____ kundër të paditurit _____.

B. Shqyrtimi i kërkesë-padisë

Shqyrtojeni kërkesë-padinë për t’u siguruar se përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për të lëshuar urdhrin. Bazuar mbi këtë shqyrtim, mund të drejtoni disa nga pyetjet e mëposhtme:

- *Çfarë lidhje keni me të paditurin?*
- *Çfarë veprimesh ka kryer i padituri?*
- *Kur kanë ndodhur këto veprime?*

- *Ku kanë ndodhur këto veprime?*
- *Kush ka qenë i pranishëm gjatë këtyre veprimeve?*
- *A keni pasur frikë nga kjo sjellje?*
- *Përse mendoni se keni nevojë për një urdhër mbrojtjeje?*

Pyetje që lidhen me palët e tjera të mbrojtura:

- *Çfarë lidhjeje keni me personat e tjerë për të cilët po kërkoni të mbrohen?*
- *Çfarë u ka bërë atyre i padituri dhe kur?*
- *Nëse janë fëmijë - a jeni ju prindi apo kujdestari ligjor i tyre?*
- *A ka lidhje fëmija/fëmijët me të paditurin?*

C. Lëshimi i urdhrit

Merrni në konsideratë kërkesat e paditësit kur shqyrtoni masat (neni 10):

- *mbi bazën e provave të paraqitura, ekzistojnë baza për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje, ose;*
- *mbi bazën e provave të paraqitura, lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i domosdoshëm për të mbrojtur direkt apo indirekt sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës (neni 17, pika 1 (b));*
- *mbi bazën e provave të paraqitura, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit (neni 17, pika 1 (b)).*
- *unë lëshoj vendimin për urdhrin e mbrojtjes dhe përfshij edhe masat e mëposhtme:*

1. unë urdhëroj që dhunuesi nuk mund të kryejë krime të tjera ndaj jush apo personave të tjerë të përmendur në urdhër;
2. unë urdhëroj që dhunuesi të mos ju kontaktojë në asnjë mënyrë juve apo personat e tjerë në urdhër.

Nëse paditësi kërkon përdorimin e banesës vetëm nga ana e tij:

- Kujt i përket prona?
- Është pronë martesore?
- A e keni emrin në dokument?
- Nëse prona është marrë më qera - e keni të qartë se ky urdhër nuk vlen për pronarin dhe unë nuk mund ta urdhëroj pronarin t'ju lejojë të qendroni nëse nuk paguhet qeraja?

1. Mbi bazën e provave, unë lejoj përdorimin e banesës vetëm nga ana juaj.
2. Mbi bazën e provave, unë urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë banesës/vendit të punës/shkollës së paditësit. I padituri nuk duhet të afrohet pranë apo ndonjë vendi tjetër _____ (emrin) më afër se _____ metra (vendosni emrin e vendit tjetër, nëse ka një të tillë). I padituri nuk duhet t'i afrohet paditësit më afër se _____ metra.
3. Dhunuesi mund të kthehet në banesë një herë në prani të punonjësve të policisë për të marrë sendet personale. Punonjësit e policisë nuk kanë shumë kohë për të pritur kështu që kjo duhet bërë shpejt dhe ndoshta ju mund t'i mbliidhni sendet e dhunuesit për të përshpejtuar procesin.
4. Mbi bazën e provave, unë urdhëroj që viktimi të ketë kujdestarinë e përkohshme të fëmijëve të mitur (përcaktoni emrat dhe moshën); që dhunuesi t'i vizitojë

fëmijët (specifikoni); që dhunuesi të paguajë (shuma e saktë) për qeranë dhe detyrimet për jetesën e familjes; që dhunuesi nuk do të mund ta shesë pronën e familjes.

Nëse paditësi nuk kërkon përdorimin e banesës vetëm nga ana e tij:

- *E di dhunuesi se ku banoni?*

Nëse jo, mos e përmendni adresën në dokumente për sigurinë e paditësit.

Unë e urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë banesës suaj, por nuk do ta përfshij adresën tuaj në urdhër dhe as nuk do t'i tregoj dhunuesit se ku banoni.

Nëse paditësi kërkon mbrojtje për vende të tjera:

- *E di dhunuesi se ku punoni?*

Nëse jo - Unë e urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë vendit tuaj të punës, por nuk do ta përfshij këtë adresë në urdhër dhe as nuk do t'i tregoj dhunuesit se ku punoni.

Nëse po - Unë e urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë vendit tuaj të punës.

- *A punoni ju dhe dhunuesi në të njëjtin vend?*

Nëse po - Unë e urdhëroj dhunuesin të mos ju afrohet në asnjë mënyrë gjatë orarit të punës dhe që të qëndrojë të paktën 100 metra larg jush në çdo kohë.

- *E di dhunuesi se ku dhe kur shkoni ju apo fëmijët në shkollë?*

Nëse jo - Unë e urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë vendit ku ju apo fëmijët shkoni në shkollë, por nuk do ta përfshij këtë adresë në urdhër dhe as nuk do t'i tregoj dhunuesit se ku shkoni në shkollë ju apo fëmijët.

Nëse po - Unë e urdhëroj dhunuesin të mos afrohet pranë vendit ku ju ose fëmijët shkoni në shkollë.

Nëse paditësi ka kërkuar që edhe ndonjë ambient tjetër të përfshihet në urdhër.

- *Përse mendoni se duhet të përfshihen edhe këto ambiente të tjera?*

Më pas vendosni dhe përdorni të njëjtin formulim si më sipër.

Ç. Armët e zjarrit

